



STATE OF NEW YORK | EXECUTIVE CHAMBER

ANDREW M. CUOMO | GOVERNOR

Për Njoftim të Menjëhershëm: 22 gusht 2013

GUVERNATORI KUOMO (CUOMO) U KUJTON SIGURUESVE TE SHERBIMEVE SHENDETESORE DHE NJEREZORE TE NJU JORKUT (NEW YORK) QE TE BEJNE KERKESHE PER 200 MILIONE DOLLARE NE FONDE TE RIMEKEMBJES NGA SENDI (SANDY)

Afati përfundimtar është 30 gushti për kërkesat për të mbuluar shpenzimet dhe për ndihmë me riparimin dhe rindërtimin e mjediseve

Guveratori Endrju M. Kuomo (Andrew M. Cuomo) u kujtoi sot organizatave që sigurojnë shërbime shëndetësore dhe njerëzore për banorët e Nju Jorkut (New Yorkers) që të bëjnë kërkesë për 200 milionë në fonde të disponueshme për kosto dhe shërbime që kanë lidhje me super stuhinë Sendi (Sandy). Afati përfundimtar për kërkesa është e premtja, 30 gusht dhe organizatat mund të bëjnë kërkesë [këtu](#).

Fondet federale, të siguruara nga Guvernatori dhe Delegacioni i Kongresit i Shtetit (State's Congressional Delegation) pas Sendit (Sandy), janë të disponueshme për të mbuluar shpenzimet e nevojshme që rezultuan nga stuhia, përfshirë shërbime shoqërore, të shëndetit e shëndetit mendor për individë e për riparime, rinovime e rindërtimin e mjediseve të kujdesit shëndetësor, mjediseve të higjenes mendore, mjediseve të kujdesit për fëmijët e mjedise të tjera të shërbimeve shoqërore. Fondet e SSBG-së mund të përdoren për të rimbursuar siguruesit për shërbimet e dhëna gjatë dhe pas Sendit (Sandy) si dhe për shpenzime në të ardhmen për të përmbushur nevojat në vazhdim të banorëve të Nju Jorkut (New Yorkers) të prekur nga stuhia.

“Siguruesit e shërbimeve shëndetësore dhe njerëzore të Shtetit të Nju Jorkut (New York State) siguruan punë që shpëtoi jetë menjëherë pas Sendit (Sandy) dhe vazhdojnë të jenë thelbësore për komunitetet që rimëkëmben nga stuhia,” tha Guvernatori Kuomo (Cuomo). “U bëj thirrje të gjitha organizatave që sigurojnë shërbime vendimtare për banorët e Nju Jorkut (New Yorkers) që të bëjnë kërkesë për këto fonde federale në mënyrë që të vazhdojnë të japin ndihmë jetësore për banorët më të prekshëm të shtetit tonë.”

Albanian

Për të trajtuar nevojat e siguruesve të shërbimeve të rëndësishme shëndetësore dhe njerëzore dhe të popullsisë të cilës i shërbejnë, Guvernatori njoftoi në korrik se Nju Jorkut (New York) do të shpërndajë 200 milionë dollar në Dhurimin federal të Bllokut Shtesë për Shërbimet Shoqërore (SSBG) të super stuhisë Sendi (Sandy) nëpërmjet një kërkesë publike dhe transparente për propozime. Kërkuesit mund të kërkojnë fonde për:

- Kostot e parimbursuara të riparimit të mjediseve, rindërtimin dhe rinovimin për siguruesit e kujdesit për fëmijët, mjediset e higjenes shëndetësore dhe mendore, qendrat për të moshuarit dhe mjediset e ngjashme dhe mjediset e tjera të shërbimeve shëndetësore dhe njerëzore si reagim ndaj super stuhisë Sendi (Sandy) përfshirë masa për t'i bërë mjediset e dëmtuara më të qëndrueshme ndaj ngjarjeve të motit të ashpër në të ardhmen.
- Rimbursim për kostot për kujdesin për fëmijët, shëndetin, shëndetin mendor, shëndetin e sjelljes, punësimin, atë të përqëndruar tek të moshuarit dhe kosto të tjera të dhënies së shërbimeve të drejtpërdrejta dhe kostot e materialeve e pajisjeve të humbura të dëmtuara të ndodhura si rezultat i super stuhisë Sendi (Sandy).
- Rimbursim ndaj bankave të ushqimeve, magazinave ushqimore dhe organizatave dhe agjencive publike që kanë lidhje me to për kostot që rezultojnë nga kërkesa në rritje për ndihmë ushqimore gjatë dhe pas super stuhisë Sendi (Sandy).
- Përmirësimin e kujdesit për fëmijët, ushqimin/ushqimet, shëndetin, kujdesin mendor, shëndetin e sjelljes, punësimin, shërbimet ligjore, ato të përqëndruara tek të moshuarit, bashkërendimin e vullnetarëve, administrimin e rasteve shërbimeve të drejtpërdrejta të tjera për të përmbushur nevojat në vazhdim të banorëve të Nju Jorkut (New Yorkers) të prekur nga Sendi (Sandy).
- Pajisje dhe furnizime të kërkuara për të dhënë shërbimet e përmirësuara në rajonet e prekura nga Sendi (Sandy).
- Kosto të tjera që kualifikohen të shërbimeve shëndetësore dhe shoqërore të pësura gjatë Sendit (Sandy) si dhe nevojat në vazhdim nga mjediset dhe siguruesit e tjerë.

Informacion mbi fondet e disponueshme dhe një lidhje për tek aplikimi në internet është i disponueshëm në

<http://nysandyhelp.ny.gov/content/sandy-social-services-block-grant-ssbg-funding>.

###

Lajme të tjera të disponueshme në www.governor.ny.gov

Shtetit të Nju Jorkut | Executive Chamber | press.office@exec.ny.gov | 518.474.8418